



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 04 Dt. 05.01.2023
PRISHTINË • PRİŠTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Në bazë të Rregullores Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), si dhe në bazë të kërkesës për inicim te procedurës disiplinore nga Shoqata e Gjyqtarëve të Federatës së Basketbollit të Kosovës (SHGJFBK), Komisioni Disiplinor i FBK-së, me datë 05.01.2023 merr këtë:

VENDIM

- I. Shpallet e PRANUESHME kërkesa e SHGJFBK-së e datës 21.12.2022.
- II. SHQIPTOHET dënim ndalesë kryerje të detyrës zyrtare për 2 lojë (në të gjitha llojet e garave zyrtare) ndaj Z. Arbër Elshanin (Drejtor Gjeneral i KB Peja), konform nenit 19 dhe 76 të Rregullores Disiplinore të FBK-së.

ARSYETIM

Me datë 21.12.2022, Komisioni Disiplinor (KD), përmes postës elektronike, nga Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, ka pranuar kërkesën për inicim të procedurës disiplinore (Kërkesa), e parashtruar nga SHGJFBK-së, lidhur me komentimet ofenduese nga Z. Arbër Elshani ndaj gjyqtarit Elldin Uglari.

Në këtë kuadër, KD ka mbajtur takim më 05.01.2023. Në takim kanë qenë prezent anëtarët e KD: Omer Daku (Kryetar), Armend Hamiti (Anëtar), Blerim Vuniqi (Anëtar), si dhe në përputhshmëri me nenin 37 të Rregullores Disiplinore, Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së dhe Këshilltaria Ligjore për Sport e FBK-së.

Para takimit, Sekretarja e Përgjithshme e FBK është autorizuar nga KD për të kërkuar deklarata nga personat e përfshirë, respektivisht nga Arbër Elshani (Drejtor Gjeneral i KB Peja), Elldin Uglari (gjyqtar) dhe nga KB Peja.

Komisioni Disiplinor, gjatë trajtimit të incidentit, ka shqyrtuar provat dhe dokumentet në dispozicion, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

1. Kompetenca e KD për të shqyrtuar rastin

Në bazë të nenit 32 të Rregullores Disiplinore, SHGJFBK ka inicuar procedurë disiplinore ndaj Arbër Elshanit dhe ka bashkangjitur prova për shkeljen e supozuar. Rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor ka kompetencë të shqyrtojë kërkesën nga SHGJFBK.

2. Meritat e Vendimit

Në mbledhjen e mbajtur më 05.01.2023, Komisioni Disiplinor ka vlerësuar sipas bindjes së lirë në bazë të provave në dispozicion.

Neni 76 i Rregullores Disiplinore të FBK-së thekson se personi i cili publikisht në mënyre jospportive kritikon referat, do të dënohet me ndalesë loje apo kryerje të detyrës në numër të caktuar të ndeshjeve ose me të holla. Lidhur me nenin 19 (paragrafi 4), dënimi ndalesë kryerje të detyrës shqiptohet në më së paku 2 e më së shumti 8 lojë.

Duke marr parasysh provat në dispozicion (postimet në rrjetet sociale nga Z. Arbër Elshani dhe deklaratat e pranuar nga FBK), Komisioni ka vendosur të shqiptojë dënim ndalesë kryerje të detyrës për 2 lojë zyrtare (në të gjitha llojet e garave) ndaj Z. Arbër Elshanit (Drejtor Gjeneral i KB Peja).

Armend Hamiti
Anëtar

KOMISIONI DISIPLINOR :

Omer Daku
Kryetar

Blerim Vuniqi
Anëtar

Prishtinë, 5 Janar 2023

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



TEB

General Sponsor:

Golden Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Vendimi i dërgohet:

- KB Peja
- Arbër Elshanit
- Elldin Uglarit
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor të FBK-së
- Arkivit të FBK-së

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Yculli Basketball supporters:

